



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 3253/h Prot

Tiranë, më 24.12.2025

Lënda: Në përgjigje të kërkesës tuaj

**QENDRËS RES PUBLICA**  
[qendra.respublica@gmail.com](mailto:qendra.respublica@gmail.com)

Në vijim të kërkesës suaj dërguar përmes postës elektronike, datë 17.12.2025, protokolluar nr. 3253 Prot., datë 18.12.2025, si dhe regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve të Zyrës së Komisionerit me nr. rendor 25, datë 18.12.2025, ju sqarojmë si më poshtë:

Zyra e Komisionerit ka mbajtur gjithmonë një qasje të hapur dhe bashkëpunuese me organizatat e shoqërisë civile, duke vlerësuar rolin e tyre në forcimin e transparencës dhe të drejtës për informim. Në këtë frymë është dërguar edhe ftesa zyrtare për pjesëmarrje në konferencë, në adresën elektronike të Qendrës “Res Publica”, [qendradespublica@gmail.com](mailto:qendradespublica@gmail.com).

Megjithatë, nga lista e pjesëmarrësve në punimet e konferencës vërejmë se, pavarësisht konfirmimit tuaj nëpërmjet e-mailit të datës 10.12.2025, ju nuk ishit i pranishëm.

Sa i takon informacionit të kërkuar për kostot organizative të konferencës, ju informojmë se të dhënat përkatëse janë ende në proces përpunimi. Sapo të jenë gati, do t’ju vihen në dispozicion. Zyra e Komisionerit mbetet e angazhuar në zbatimin e parimit të transparencës dhe në garantimin e së drejtës për informim, në përputhje me ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”.

Për sa i përket përzgjedhjes, pikës 2 të kërkesës suaj, konstatojmë se ajo nuk përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar. Megjithatë, përbërja e panelit të parë pasqyron kontributet dhe rolin e rëndësishëm që shoqëria civile dhe mediat kanë treguar në nxitjen dhe forcimin e kulturës së transparencës.

Zyra e Komisionerit vlerëson dhe falënderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë konferencë.

Falënderit,

**KOORDINATORI**  
**Alketa Koca**